



REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA E ISTOGUT

KONTRATË PËR PUNË

KOMUNA E ISTOGUT në vazhdim "Njësia e Prokurimit", të cilën e përfaqëson znj, Zizë Bujupaj, menaxhere e Prokurimit, Rruga "Fadil Ferati" Nr. 121 në njërën anë;

Dhe

Konzorciumi "Horn&Co Kosova" & NN "Asfalti" SHPK nga Lëbusha, Komuna e Deçanit, perkatësisht Peja, të cilën e përfaqëson z. Admir Hasanaj, me Nr. Rexh. Biznesi, 71179850 (në vazhdim "Kontraktuesit"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për punë e shënuara me poshtë:

TITULLI I KONTRATËS:

MIRËMBAJTJA E RRUGËVE MALORE – LUGU I BUTË L=52000

Nr. I prokurimit	633 / 018 / 959 / 521 – lot 1
Nr. I brendshëm	633 / 018 / 009 / 521 – lot 1

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i punëve në vijim nga ana e Kontraktuesit:

MIRËMBAJTJA E RRUGËVE MALORE – LUGU I BUTË L=52000

Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi total i punëve për aktivitetin e prokurimit **MIRËMBAJTJA E RRUGËVE MALORE – LUGU I BUTË L=52300 është: 17.130,00 €** dhe me fjalë: /Shtatëmbëdhjetë mijë e nënëqind e tridhjetë/zerozero €

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve përgjatë ekzekutimit të kontratës.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

Marrëveshja e kontratës;
Kushtet e Veçanta të Kontratës;
Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
Oferta financiare (Paramasa dhe Paralogaria);
Plani për menaxhimin e kontratës
Procesverbalet e Vizitës në teren e mbikqyresit

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 4 Komunikimet

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.

4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për



pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimin të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

Për Autoritetin Kontraktues:

Për Kontraktuesin:

Emri:	Zizë Bujupaj	Emri:	Admir Hasanaj
Pozita:	Zyrtar Përgjrgjës i Prokurimit	Pozita:	Lideri i grupit
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	05.05.2018	Data:	04.05.2018
Vula		Vula	

KOMUNA E ISTOGUT					
TITULLI I AKTIVITETIT					
PARAMASA DHE PARALLOGARIA					
	Specifikimi i punëve	Njësia	Sasia	Germimi Njesi	Gjithsejt

1	Loto Nr. I Njesia Menaxhuese -Lugu I bute L=52000 m				
---	---	--	--	--	--

1.1	Germimi I materialit natyral afer rruges,Transporti dhe shtruarja ne pjeset e demtuara te rruges	m³	7,700	1.8 €	13,860.0 €
1.2	Hapja e kanaleve anesore aty ku eshte e nevojshme dhe pastrimi I kalesave	m'	2,000	1.5 €	3,000.0 €
1.3	Vendosja e gypave te betonit φ 500per largimin e ujit	cope	18	15.0 €	270.0 €
1.4	TOTALI ME TE GJITHA NGARKESAT (GJITHSEJ 1+2+3)				
TOTALI ME TE GJITHA NGARKESAT LOTO 1					17,130.00

2	Loto Nr. II-Njesia Menaxhuese "Radusha" L=52300 m				
---	---	--	--	--	--

2.1	Germimi I materialit natyral afer rruges,Transporti dhe shtruarja ne pjeset e demtuara te rruges	m³	7,800		
2.2	Hapja e kanaleve anesore aty ku eshte e nevojshme dhe pastrimi I kalesave	m'	1,900		
2.3	Vendosja e gypave Ø500 per largimin e ujit	cope	18		
TOTALI ME TE GJITHA NGARKESAT LOTO 2					

PJESA III E KONTRATES***kushtet e veçanta***

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

<i>Kushtet e Përgjithshme të Kontratës</i>		<i>Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK</i>
<i>Përshkrimi i nenit</i>	<i>Neni. Nr.</i>	
<i>Ligji zbatueshëm dhe gjuha</i>	<i>2.1</i>	<i>Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.</i>
	<i>2.2</i>	<i>Gjuha e përdorur do të jetë gjuha SHQIPE</i>
<i>Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit</i>	<i>7.2</i>	<i>Shuma minimale e sigurimit do të jetë: sipas Ligjeve në fuqi që rregullojnë lemin e siguracioneve.</i>
<i>Programi</i>	<i>8.1</i>	<i>Kontraktuesi do ta dorëzojë për aprovim Programin për Punët brenda 3. ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës.</i>
<i>Siguria e ekzekutimit</i>	<i>10</i>	<i>Shuma e sigurisë së ekzekutimit është: 10% e shumës totale të kontratës, në një afat prej 90 ditësh.</i>
<i>Fillimi i punëve</i>	<i>17.1</i>	<i>Data e fillimit do të jetë menjëherë pas nënshkrimit të kontratës, gjegjësisht me datë kur menaxheri i kontratës e përcakton në ditarin e punës dhe Librin ndërtimor si dhe PLANIN PËR MENAXHIM TË KONTRATËS</i>
<i>Përfundimi i punimeve</i>	<i>17.2</i>	<i>Data e përfundimit e të gjitha Punëve dhe furnizimeve do të jetë: 60 ditë pune.</i>

Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë llogaritura për ditë dhe atë 0.25 % për ç'do ditë vonese te paarsyeshme. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është 10 % e çmimit final të Kontratës.
Inspektimi dhe testimi	22.1	Menaxheri i projektit ose ZKA do ta caktojë një mbikqyres për implementimin e kontratës, i cili do ta mbikqyrë dhe do të raportojë tek Autoriteti Kontraktues.
	24.1	Pagesat do të bëhen në euro ashtu si raporton Organi Mbikqyrës bazuar në raportin e mbikqyresit, pas kryerjes së punimeve për situacionet përkatëse.
Përmirësimi i defekteve	31.1	Periudha garantuere e defekteve është 365 ditë, pas përfundimit të punimeve, bazuar në deklaratën e kontraktorit, sigurimin e cilësisë së punimeve.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.1	KOMUNA E ISTOGUT – DREJTORATI PERKATËS I INICIMIT TE KERKESËS DHE IMPLEMENTUESI I PROJEKTIT
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykata Themelore - Departamenti për çështje Ekonomike - Prishtinë. Palet duhet të deklarohen para nënshkrimit të kontratës – për KOMPETENCËN, për kontestet eventuale Gjykata apo Arbitrazhi